

An aerial photograph of a city, likely in the Balkans, featuring a river flowing through it. In the foreground, a steep, rocky cliff with a staircase leads down to the riverbank. The city buildings are visible in the background, nestled between the river and distant mountains.

PLANI I INTEGRUAR I VEPRIMIT PËR TRASHËGIMINË DISONANTE. NË PËRMET

**PLANI I INTEGRUAR I VEPRIMIT U PËRGATIT NGA
"GRUPI LOKAL URBACT NË PËRMET"**

**ALEKS TANE
ARDIAN GOGO
ARJANA PAPAPANO
AULONA MESHINI
DENISA MAMILLO
ELIDJON MALIQI
GENTIAN LILE
JOSHUA CORTESE
JULIAN ELEZI
KLAUDJA CIKO
KLEVIS GURA
KLODJAN KRECI
KRISTJANA IBRAHIMI
RUDINA BALLABANI**

HYRJE NGA KRYETARI I BASHKISË

Për vite me radhë, trashëgimia disonante e Përmetit ka mbetur e lënë pas dore—rëndësia e saj është anashkaluar dhe potenciali i saj nuk është shfrytëzuar. Megjithatë, këto vende janë më shumë sesa relike të së kaluarës; ato janë pjesë e historisë sonë dhe mund të shërbejnë si mjete të fuqishme për arsim, turizëm dhe angazhim kulturor. Sot, kemi mundësinë të ripërcaktojmë rolin e tyre, duke i transformuar ato në hapësira që nxisin dialogun, të nxëniet dhe pjesëmarrjen qytetare.

Ky Plan i Integruar Veprimi, i zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës, siguron që çdo palë e interesuar të ketë një zë në formimin e së ardhmes së këtyre vendeve historike. Duke punuar së bashku, ne synojmë t'i ruajmë, restaurojmë dhe integrojmë ato në strategjitë më të gjera të zhvillimit të turizmit të Përmetit. Përmes investimeve të synuara, iniciativave edukative dhe përpjekjeve promovuese, këto vende mund të bëhen qendra dinamike të ndërgjegjësimit historik dhe mundësive ekonomike.

Vizioni ynë nuk ka të bëjë vetëm me ruajtjen e së kaluarës, por me shfrytëzimin e saj për të ndërtuar një të ardhme më të fortë dhe ekonomikisht më të gjallë për Përmetin. Duke e riimagjinuar trashëgiminë disonante si një katalizator për turizmin, arsimin dhe angazhimin kulturor, ne nderojmë historinë duke formësuar mundësi të reja për brezat e ardhshëm.

Së bashku, le ta rigjallërojmë të kaluarën e Përmetit, duke u siguruar që ajo jo vetëm të tregojë historinë e vendeve ku kemi qenë, por edhe të formojë rrugën përpara për brezat e ardhshëm dhe të gjithë komunitetin.

Alma Hoxha- Kryetar Bashkia Përmet

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani i Integruar i Veprimit (IAP) është zhvilluar nga Grupi Lokal URBACT (ULG) si pjesë e ARCHETHICS, një projekt i financuar nga URBACT IV. Ky plan i orientuar në të ardhmen adreson sfidat që lidhen me trashëgiminë disonante në Përmet. Duke shërbyer si një mjet politikash strategjike, ai ofron zgjidhje konkrete për çështjet specifike të identifikuara.

Trashëgimia disonante në Përmet, e përbërë nga objekte nga epoka komuniste dhe pushtimi italian, mbetet e pazhvilluar si një aset turistik dhe arsimor, për shkak të mirëmbajtjes së dobët, aksesit të kufizuar dhe promovimit të pamjaftueshëm. Këto vende shpesh përjashtohen nga strategjitë më të gjera të turizmit dhe nuk shfrytëzohen sa duhet për qëllime arsimore, me përfshirje minimale të palëve të interesuara në përpjekjet e ruajtjes dhe angazhimit. Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, vizioni është t'i transformojmë ato në destinacione turistike të qëndrueshme dhe qendra kulturore dhe arsimore, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Bashkisë së Përmetit. Kjo kërkon investime në infrastrukturë, integrim në turizmin lokal dhe bashkëpunim me palët e interesuara për të rritur dukshmërinë dhe për të nxitur rritjen ekonomike. Me anë të organizimit të vizitave, ekspozitave dhe evente komunitare, trashëgimia disonante mund të shërbejë si një mjet për edukim dhe dialog, duke nxitur ndërgjegjësimin historik dhe duke krijuar mundësi të reja për angazhim kulturor. Kjo logjikë pasqyrohet në Planin e Integruar të Veprimit, i cili është strukturuar në katër seksioni.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Seksioni 1 prezanton projektin ARCHETHICS, informacion mbi Përmetin, duke përfshirë njohuritë kryesore mbi trashëgiminë disonante dhe sfidat me të cilat ajo përballë. Më pas paraqitet vizioni i përbashkët për të ardhmen dhe një vetëvlerësim i sfidave kryesore të integritetit. Ky plan është përgatitur nga Grupi Lokal URBACT (ULG). Në këtë seksion, theksohet puna e ndërmarrë nga grupi, duke shfaqur rolin e tyre si një mjet kyç në hartimin e planit.

Seksioni 2 përcakton të gjithë veprimet e planifikuara për të arritur vizionin e përgjithshëm, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me nevojat e identifikuar. Ky kapitull prezanton objektivat strategjike dhe specifike, të ndjekur nga një përshkrim i shkurtër i dhjetë veprimeve të identifikuar.

Seksioni 3 i trajton këto veprime në detaje, duke mbuluar hapat e zbatimit, kostot, burimet e financimit, subjektet përgjegjëse, treguesit e monitorimit dhe masat për zbutjen e rrezikut.

Seksioni 4 përshkruan kornizën e zbatimit, duke theksuar faktorët kryesorë për ekzekutim të suksesshëm. Këto përfshijnë bashkëpunim dhe mbështetje të fortë nga partnerët kryesorë, veçanërisht anëtarët e ULG-së; tregues të qartë monitorimi; një vlerësim të plotë të rrezikut me masa përkatëse zbutëse; fizibilitetin e kostos dhe identifikimin e burimeve të financimit; dhe një nivel të lartë gatishmërie për veprim, të përforcuar nga testimi paraprak i veprimeve të caktuara për efektivitet.

TABELA E PËRMBAJTJES

KONTEKSTI, NEVOJAT DHE VIZIONI I QYTETIT	7
Hyrje	8
Projekti ARCHETHICS	9
Trashëgimia disonante në Përmet	12
Sitet kryesore të trashëgimisë disonante në Përmet	14
Profili i qytetit	15
Strategjitë, politikat dhe aktivitetet ekzistuese	19
Identifikimi i problematikave	20
Analiza SWOT	21
Grupet lokale të interesit	22
Përmet ULG	24
Vizioni	27
Sfidat kryesore të integritimit	28
LOGJIKA E PËRGJITHSHME	29
Objektivat dhe fushat e ndërhyrjes	32
Veprimet	33
Detajet e veprimeve të planifikuara	37
KORNIZA E VEPRIMIT	68

KONTEKSTI, NEVOJAT DHE VIZIONI I QYTETIT



HYRJE

Plani i Integruar i Veprimit (IAP) është zhvilluar si pjesë e **ARCHETHICS** — një projekt i financuar nga **URBACT IV**. Ky program bashkëfinancohet nga Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal (ERDF), Instrumenti për Ndihmë i Para-Anëtarësimit dhe Instrumenti i Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar.

URBACT IV mbështet qytete të të gjitha madhësive — nga lagjet deri te zonat e tëra urbane, në përmirësimin e qasjeve të tyre ndaj zhvillimit të qëndrueshëm urban duke përdorur metodologjinë URBACT. Elementet kryesore të programit përfshijnë pjesëmarrjen aktive të grupeve lokale të interesit, rrjetëzimin dhe shkëmbimin e njohurive midis qyteteve, si dhe udhëzimet e ekspertëve.

IAP është **rezultati kryesor** i Bashkisë së Përmetit brenda rrjetit ARCHETHICS. Ai u përgatit nga Grupi Lokal URBACT (ULG) me mbështetje nga grupet lokale të interesit, eksperti kryesor i ARCHETHICS dhe qytetet e përfshira në projekt.

Është një plan koherent dhe i orientuar drejt së ardhmes që trajton sfidat e trashëgimisë disonante në Përmet. Në përputhje me objektivat strategjike të tij, veprimet e planifikuara janë specifikuar në detaje, duke përfshirë afatet kohore, përgjegjësitë, treguesit e monitorimit dhe strategjitë e menaxhimit të riskut për zbatim të suksesshëm. Ai do të shërbejë si një mjet i vlefshëm politikash, duke ofruar një përgjigje konkrete ndaj sfidave specifike të identifikuara.

PROJEKTI ARCHETHICS

Projekti ARCHETHICS i udhëhequr nga Bashkia e Cesenës, bashkon qytete evropiane me madhësi të ndryshme: Cesena në Itali; Përmeti në Shqipëri; Kazanlak në Bullgari; Krakow në Poloni; Gdansk në Poloni; Leipzig në Gjermani; Betera në Spanjë dhe Vila Nova de Cerveira në Portugali. Këto qytete kanë të përbashkët praninë e trashëgimisë disonante.

Objektivi i ARCHETHICS është të eksplorojë qasje të reja për të ndërtuar politika të qëndrueshme urbane mbi Trashëgiminë Disonante:

- për të rritur **trashëgiminë disonante si një element jo-përçarës të komuniteteve urbane**, por si një pikënisje për formimin e identiteteve të reja demokratike.
- për të gjeneruar një kuptim më të mirë se si **menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme trashëgimia disonante**.
- për të aktivizuar **laboratorët e komunitetit urban** rreth vlerave të përbashkëta evropiane.
- të hapë **perspektiva dhe mundësi të reja** për të përmirësuar trashëgiminë disonante si një atraksion investimi dhe një nxitës për zhvillimin turistik dhe kulturor lokal.

ARCHETHICS ndan këtë vizion për qytetin e së ardhmes, ku trashëgimia disonante bëhet korniza fillestare për të përmirësuar identitetin individual dhe kolektiv, sjelljen dhe kujtesën, duke forcuar marrëdhënien midis arkitekturës, qytetarisë dhe etikës. Ajo lexon disonancën e trashëgimisë kulturore përmes analizës së katër dimensioneve: Arkitektura, Njerëzit, Historia dhe Etika.

KATËR DIMENSIONET E ARCHETHICS

ARKITEKTURA përfaqëson trashëgiminë materiale, objektet, monumentet dhe ndërtesat e ndërtuara në të kaluarën si mjet propagande i regjimeve diktatoriale për të ndërtuar konsensus, për të kontrolluar njerëzit ose si mbrojtje ushtarake të kufijve konfliktualë.



Dimensioni **“NJERËZIT”** përqendrohet në rëndësinë e përfshirjes në debatin rreth trashëgimisë disonante të të gjithë aktorëve, si vendasve ashtu edhe turistëve, brezit të ri dhe të moshuarve, ekspertëve dhe njerëzve të thjeshtë, vajzave dhe djemve, grave dhe burrave.



HISTORIA përfaqëson marrëdhënien delikate midis kujtesës publike/institucionale dhe kujtesës individuale. Përmes historisë, ARCHETHICS analizon kujtimet e pakëndshme, stigmën, lajmet e rreme dhe faktet e heshtura të fshehura në trashëgiminë disonante.



ETIKA do të thotë njohja e vlerave të përbashkëta pozitive që komuniteti lokal synon t'i adresojë trashëgimisë disonante. Interpretimi kritik dhe njohja e disonancës brenda trashëgimisë kulturore mund të çojë drejt një sfondi të përbashkët pozitiv.



CILI ËSHTË KUPTIMI I TRASHËGIMISË DISONANTE?



Historia e Evropës ka gjeneruar një trashëgimi që nganjëherë është kontraverse dhe komplekse për shkak të përkatësisë në regjime totalitare ose kufij të diskutueshëm. Kjo trashëgimi është quajtur "Disonante", duke trajtuar lidhjen problematike midis elementëve fizikë si arkitektura, lagjet, monumentet, hapësirat publike urbane dhe vlerat historike dhe politike që përfaqësojnë këta elementë.

Në kontekstin e ARCHETHICS, trashëgimia disonante i referohet trashëgimisë arkitekturore dhe kulturore që ngjall kujtime të pakëndshme për shkak të luftës ose propagandës politike të regjimeve totalitare ose kufijve kontroversë që ka vuajtur shoqëria, duke lidhur elementët fizikë (ndërtesat, rrugët, sheshet, etj.) dhe historikun, kontekstin politik dhe vlerat që i prodhuan ato në të kaluarën. Trashëgimia disonante e analizuar nga ARCHETHICS është shpesh e heshtur dhe e panjohur nga komuniteti. Për këtë arsye, projekti propozon një qasje shumëdimensionale për të lexuar historinë, për të mbledhur dëshmi dhe për të ardhur me iniciativa pjesëmarrëse për të menaxhuar trashëgiminë disonante.


TRASHËGIMIA DISONANTE NË PËRMET

*Foto e Takimit të
Kongresit*

Trashëgimia disonante në Përmet i referohet trashëgimisë kulturore dhe arkitekturore kontraverse që buron si nga periudha komuniste (1944-1991) ashtu edhe nga pushtimi italian (1939-1943). Kjo trashëgimi përfshin ndërtesa, monumente dhe objekte të ndryshme historike që u ndërtuan ose u krijuan për të pasqyruar një kuadër specifik politik dhe ideologjik. Sot, ato mbeten në qendër të debateve në lidhje me rëndësinë e tyre historike dhe rolin që luajnë në shoqërinë bashkëkohore.

Struktura më domethënëse është ndërtesa ku u zhvillua Kongresi i Përmetit. Kjo ndërtesë historike shërbeu si vendi ku, më 24 maj 1944, udhëheqësit komunistë shqiptarë u mbledhën me 188 delegatë nga i gjithë vendi për të nisur Kongresin. Përmeti u zgjodh për këtë takim të rëndësishëm për tre arsye kryesore:

- Ishte qyteti i parë që u çlirua.
- Vendndodhja e tij gjeografike ishte strategjiksht e favorshme.
- Ishte vendlindja e disa udhëheqësve të shquar të Rilindjes Kombëtare.



TRASHËGIMIA DISONANTE NË PËRMET



Kongresi synonte të zgjidhte autoritete legislative dhe ekzekutive që do të qeverisnin Shqipërinë deri në fund të luftës. Ndër shumë vendime të rëndësishme të marra, më i rëndësishmi ishte angazhimi për ndërtimin e një Shqipërie të re demokratike dhe të përqendruar te populli. Megjithatë, për shkak të lidhjes së saj me fillimin e regjimit komunist, ndërtesa u neglizhua kryesisht dhe u shkatërrua pas rënies së komunizmit.

- Ndodhet pranë qendrës së qytetit dhe u ndërtua midis viteve 1938 dhe 1940 nga ushtria italiane dhe shërbeu si kazermë ushtarake deri në vitin 1944. Shtëpia ka një formë drejtkëndëshe dhe përmasat 29.3 m x 8.9 m, e përbërë nga dy dhoma. Çatia është mbuluar me dërrasa asbesti dhe sot me pllaka. Brënda ndërtesës ndohet muzeu i luftës, i cili ka rritur ndjeshëm numrin e vizitorëve. Ai ka statusin e Monumentit Kulturor të Kategorisë së Parë.



Muzeu i Luftës

SITE TË TJERA TË TRASHËGIMISË DISONANTE NË PËRMET

SHTËPIA E OFICERËVE

Është një ndërtesë historike me rëndësi të madhe, e cila shërbeu si rezidencë për oficerët gjatë periudhës komuniste. U shkatërrua në vitin 1997 dhe u rindërtua në vitin 2012 si "Qendra Kulturore Multifunksionale Odhise Paskali". Sot, ndërtesa shërben si një qendër kulturore, duke ofruar ekspozita muzeale, një sallë të dedikuar konferencash dhe një sallë ekspozitash, përveç funksionimit si një pikë informacioni turistik.

KINEMAJA "13 SHTATORI"

Fillimisht funksionoi si kinema gjatë regjimit komunist, por kjo strukturë u rinovua në vitin 2022. Sot, ajo vazhdon të funksionojë si kinema dhe shërben si qendër për aktivitete kulturore.




**BUNKERE, TUNELE,
VENDSTREHIME,
MONUMENTE**



**RRËNOJAT E KAZERMËS
ITALIANE**

PROFILI I QYTETIT




Bashkia e Përmetit është pjesë e Qarkut të Gjirokastrës dhe ndodhet në pjesën juglindore të vendit. Bashkia e Përmetit përbëhet nga pesë njësi administrative: Përmet, Çarshovë, Frashër, Petran dhe Qendër Piskovë. Ajo administron një qytet dhe 49 fshatra. Të gjitha njësitë administrative brenda bashkisë janë zona malore, pasi më shumë se 45% e terrenit është e pjerrët dhe e thyer. Qendra administrative e bashkisë është qyteti i Përmetit, i cili shërben si qendër ekonomike dhe sociale jo vetëm për Bashkinë e Përmetit, por edhe për të gjithë bashkësinë gjeografike të njohur si Lugina e Vjosës.




Popullsia: 19,872 banorë
56% banojnë në qytet

Gratë përfaqësojnë 50% të popullsisë së përgjithshme.

Grupmosha 15-64 vjeç përbën 66% të popullsisë së Përmetit. Grupmosha 65+ vjeç përbën 18%, duke tejkaluar mesataren kombëtare (11.3%), ndërsa grupmosha 0-14 vjeç përfaqëson 16%, duke qenë nën mesataren kombëtare (20.7%).




PROFILI I QYTETIT



Aktivitetet kryesore ekonomike:


- Bujqësi
- Blegtori
- Agroindustri
- Turizëm
- Tregti

Turizmi është një sektor kyç që nxit zhvillimin ekonomik të Përmetit. Rrethi ofron një gamë të larmishme mundësish turistike, duke përfshirë ekoturizmin, turizmin kulinar, turizmin aventuresk (kanoe, ngjitje malore), turizmin shëndetësor, turizmin rural, turizmin fetar dhe turizmin kulturor.




PËRVEÇ DETIT, NE KEMI GJITHÇKA TJETËR!

PËRVEÇ DETIT, KEMI GJITHÇKA TJETËR!



VIZIONI I ZHVILLIMIT TË PËRMETIT



“Përmeti, një portë hyrëse në Shqipëri, me trashëgimi natyrore dhe kulturore autoktone dhe unike, me histori e tradita e me pontecial të larta për zhvillim ekonomik bazuar në bujqësi, blegtori dhe agrobiznes, orienton ekonominë drejt turizmit rural, natyror, shëndetësor dhe kulturor, mbështetur në infrastrukturë dhe shërbime të përshtatshme, duke u transformuar në një destinacion unik shqiptar.”

STRATEGJITË, POLITIKAT DHE AKTIVITETET EKZISTUESE

Ndërtesa të tjera historike janë rindërtuar dhe tani janë në përdorim, siç janë Kinemaja dhe Qendra Kulturore.

Në kryeqytet, ripërdorimi i vendeve të trashëgimisë disonante për turizëm dhe arsim ka qenë shumë i suksesshëm, me atraksione si Bunk'Art dhe Shtëpia e Gjetheve që janë bërë destinacione kryesore turistike.

Bashkia dhe operatorët turistikë vendas po bashkëpunojnë për ta përfshirë këtë trashëgimi në ofertën turistike të zonës.

Bashkia e Përmetit po zbaton një projekt tjetër të fokusuar në trashëgiminë disonante dhe planifikon të aplikojë për projekte të tjera me një fokus të ngjashëm.

Në Planin e Përgjithshëm Vendor shumë nga këto ndërtesa historike dhe kulturore konsiderohen të rëndësishme për zhvillimin e turizmit dhe theksohet nevoja për ruajtjen dhe promovimin e tyre.

Salla e Kongresit u restaurua së fundmi dhe brenda ndërtesës u krijua një muze lufte, duke tërhequr më shumë vizitorë në këtë ndërtesë historike.



IDENTIFIKIMI I PROBLEMATIKAVE

PAVARËSISHT POTENCIALIT TË TYRE TË KONSIDERUESHËM TURISTIK, VENDET E TRASHËGIMISË DISONANTE ENDE NUK JANË SHNDËRRUAR NË DESTINACIONE TURISTIKE TË NJOHURA.

Vendet e trashëgimisë disonante në Përmet përballen me disa sfida që kufizojnë potencialin e tyre si destinacione turistike. Shumë prej tyre mbeten të pa rikonstruktura ose mirëmbahen në mënyrë të pamjaftueshme, gjë që rezulton në akses të kufizuar dhe përvoja të dobëta për vizitorët. Mungesa e sinjalistikës informuese dhe e informacionit të detajuar historik lë vizitorët potencialë të pa informuar mbi rëndësinë kulturore të këtyre vendeve. Për më tepër, promovimi i pamjaftueshëm nga operatorët turistikë dhe autoritetet lokale redukton dukshmërinë e tyre në një treg konkurrues. Së fundi, këto vende shpesh nuk përfshihen në planet strategjike për turizmin dhe zhvillimin urban, duke çuar në investime të kufizuara dhe përpjekje të pamjaftueshme të koordinuara për ruajtjen e tyre.

TRASHËGIMIA DISONANTE PËRDORET PAK OSE ASPAK PËR QËLLIME EDUKUESE DHE KULTURORE.

Pavarësisht se ofrojnë një pasqyrë unike të së kaluarës, këto vende nuk ofrojnë programe apo aktivitete të mjaftueshme për të ndihmuar njerëzit të lidhen me këtë pjesë të historisë. Shumë shkolla i vizitojnë rrallë ose nuk përdorin materialet e disponueshme, ndërsa shumë dokumente dhe objekte historike nuk janë ruajtur mirë dhe mbeten të vështira për t'u aksesuar, pasi ekzistojnë vetëm në formë fizike dhe jo digjitale. Me kalimin e kohës, ruajtja e këtyre burimeve do të bëhet edhe më sfiduese. Gjithashtu, aktivitete të lidhura me trashëgiminë disonante organizohen shumë pak nga bashkia ose aktorë të tjerë



ANALIZA SWOT

PIKAT E FORTA

- Turizmi në Përmet është shumë i zhvilluar.
- Numër i lartë fotosh dhe dokumentesh rreth periudhës së komunizmit (të pranishme në ndërtesën e Kongresit).
- Nuk ka probleme pronësie.
- Ato janë të vendosura kryesisht në qendër.
- Zbatimi i projekteve të tjera me tema të ngjashme.
- Bashkëpunim i mirë me shkollat dhe OJQ-të.



DOBËSITË

- Mungesa e një “historie të përbashkët”, një histori që nuk “politizohet”.
- Gjendja e ruajtjes së trashëgimisë italiane/fashiste: është pothuajse e shkatërruar.
- Mungesa e një plani mbrojtës për trashëgiminë disonante.
- Mungesa e adresimit të politikave për trashëgiminë disonante në planin e përgjithshëm të qytetit.
- Buxheti i kufizuar për investime.



MUNDËSI

- Rritje e numrit të turistëve dhe netëve të qëndrimit.
- Interes për zgjerimin e sektorit turistik duke eksploruar potencialin e trashëgimisë disonante.
- Vlerësimi i materialeve fotografik përmes digjitalizimit.
- Turizmi kulturor dhe historik është një përparësi kombëtare.
- Më shumë akses në fondet e donatorëve të huaj.



KËRCËNIMET

- Ndarje e mëtejshme në ndarjen e një historie të përbashkët.
- Ndryshimi i orientimit turistik. Rreziku i mbi-marketingut.
- Ndryshimi i përparësive të investimeve.



GRUPET LOKALE TË INTERESIT

Qasja pjesëmarrëse është një aspekt themelor i rrjeteve URBACT dhe i këtij Plani të Integruar të Veprimit. Përfshirja e palëve të interesuara të duhura që nga fillimi i këtij udhëtimi është thelbësore për zhvillimin e një Plani Veprimi të Integruar (IAP) që është si praktik ashtu edhe i rëndësishëm. Kështu, hapi i parë ishte identifikimi i grupeve të interesit. Ato mund të kategorizohen në katër grupe kryesore:

SEKTORI PRIVAT

- **Bizneset lokale në industrinë e turizmit.**
- **Guida turistike, agjenci udhëtimesh dhe operatorë turistikë lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë.**
- **Organizata joqeveritare (OJQ) të përqendruara në zhvillimin e turizmit, trashëgiminë kulturore, arsimin dhe angazhimin e të rinjve.**

SEKTORI PUBLIK

- **Bashkia Përmet.**
- **Bashki të tjera në rajon.**
- **Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.**
- **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.**
- **Institucionet kulturore.**

SEKTORI ARSIMOR

- **Shkollat në Përmet.**
- **Zyra Lokale Arsimore**
- **Studiues.**
- **Universitetet.**
- **Historianët.**

KOMUNITETI

- **Mosha e tretë**
- **Të rinjtë (përfshirë Këshillin Rinor)**
- **Influencer**
- **Individë të tjerë të interesuar.**

Pas identifikimit të grupeve të interesit, hapi tjetër është angazhimi i tyre aktiv në adresimin e sfidave të trashëgimisë disonante në Përmet. Kjo mund të bëhet duke krijuar një Grup Lokal URBACT (ULG) dhe duke emëruar koordinatorin e duhur për të drejtuar grupin.

ÇFARË ËSHTË NJË GRUP LOKAL URBACT?

Grupet Lokale të URBACT (ULG) janë një element themelor i programit URBACT. Çdo partner në një projekt URBACT duhet të krijojë një ULG për të bashkuar të gjithë grupet lokale të interesit që lidhen me sfidën e zgjedhur që dëshirojmë të trajtojmë. Roli i tyre kryesor është të analizojnë çështjet lokale, të eksplorojnë zgjidhjet dhe në fund të fundit të hartojnë dhe zbatojnë strategji për t'i adresuar ato.

PËRMET ULG

Grupi ynë kryesor Lokal URBACT (ULG) përbëhet nga 18 anëtarë që përfaqësojnë kategoritë e grupeve të interesit të përmendura më sipër.

Departamentet e bashkisë

- **Arsimi**
- **Shërbimet sociale**
- **Turizmi dhe trashëgimia kulturore**
- **Planifikimi urban**
- **Projektet me donatorë të huaj**

- Organizata Joqeveritare (OJQ)
- CESVI
- VJOSA EXPLORER

- Mësues të historisë së shkollës “Nonda Bulka” dhe “Sejfulla Malshova”
- Historianë lokalë

- Këshilli Rinor i Përmetit
- Guida turistike lokale
- Anëtarët e komunitetit
- Të moshuarit

PËR MET U LG

Nga Shtatori 2023 deri në Dhjetor 2024, ULG zhvilloi tetë takime me pjesëmarrje fizike.

DATA	TEMA	NUMRI I PJESËMARRËSVE
26.09.2023	Hyrje + kuptim i situatës lokale.	7 femra dhe 4 meshkuj
14.12.2023	Trashëgimia disonante në Përmet: konteksti lokal dhe sfidat, analiza SWOT.	6 femra dhe 8 meshkuj
21.02.2024	Identifikimi i problematikave.	5 femra dhe 7 meshkuj
12.03.2024	Identifikimi i problematikave + vizioni i përbashkët për ndryshim.	8 femra dhe 10 meshkuj
27.04.2024	Vizioni për ndryshim nga perspektiva e të rinjve.	22 femra dhe 12 meshkuj
02.07.2024	Identifikimi i objektivave strategjike dhe specifike të IAP-it.	7 femra dhe 9 meshkuj
20.11.2024	Detajimi i veprimeve të IAP	3 femra dhe 6 meshkuj
20.12.2024	Detajimi i veprimeve të IAP+ korniza e zbatimit.	6 femra dhe 3 meshkuj

PËRMET ULG


Trashëgimia disonante është një temë e ndjeshme, duke e bërë thelbësore të sigurohet që zëri i çdo pale të interesuar të dëgjohet. Për ta lehtësuar këtë, u mbajtën takime shtesë midis muajit Prill dhe Maj 2024, secili i dedikuar për një grup specifik: të rinjtë, mosha e tretë, bizneset lokale dhe historianët.

Këto takime kishin për qëllim identifikimin e sfidave që lidhen me trashëgiminë disonante në Përmet, përcaktimin e një vizioni të përbashkët për të ardhmen e saj dhe përcaktimin e veprimeve kryesore për arritjen e këtij vizioni. Arritja e një konsensusi për vizionin e IAP ishte sfiduese për shkak të perspektivave të ndryshme të pjesëmarrësve. Megjithatë, nëpërmjet angazhimit aktiv të të gjithë anëtarëve të ULG-së dhe mbështetjes së partneritetit ARCHETHICS, u krijua me sukses një vizion i përbashkët.

Ne besojmë se trashëgimia jonë disonante mund të jetë një mjet i fuqishëm për arsimin dhe turizmin dhe mund të përdoret në dobi të komunitetit tonë.



VIZIONI



VENDET E TRASHËGIMISË DISONANTE NË
PËRMET TË SHNDËRROHEN NË
DESTINACIONE TË PREFERUARA
TURISTIKE DHE VENDE ME VLERA TË
LARTA EDUKUESE DHE SOCIO-
KULTURORE.

SFIDAT KRYESORE TË INTEGRIMIT

Në tabelën më poshtë është një vetëvlerësim i aspekteve kryesore të integrimit.

Aspektet e integrimit	Vetëvlerësim (1-5)	Përshkrim
Përfshirja e grupeve të interesit në planifikim	5	Që nga fillimi, ne identifikuam dhe përfshimë me kujdes palët e interesuara të duhura. Perspektivat e tyre të ndryshme paraqitën sfida, megjithatë, një angazhim efektiv u arrit nëpërmjet metodave, mjeteve dhe takimeve të duhura në kohën e duhur.
Koherenca me strategjitë ekzistuese	5	Plani është koherent me strategjitë, politikat dhe aktivitetet ekzistuese.
Zhvillimi i qëndrueshëm urban (ekonomik, social, mjedisor)	5	Plani përfshin të tre shtyllat e zhvillit urban të qëndrueshëm: ekonomik, social dhe mjedisor.
Integrimi në kohë.	5	Cdo hap i secilit veprim u planifikua me kujdes duke konsideruar dhe kohën dhe rendin e implementimit.
Përfshirja e grupeve të interesit në implementim.	4	Palët e interesuara ishin të përfshira në mënyrë aktive gjatë gjithë procesit, që nga planifikimi deri te zbatimi i aktiviteteve të testimit. Megjithatë, për shkak të kohës së kufizuar, nuk u arrit angazhimi i plotë nga të gjithë pjesëmarrësit.
Integrimi sektorial	5	Plani adresoi shumë sektorë si: turizimi, trashëgimia kulturore, historia, arsimi and jeta socio-kulturore.
Integrimi hapësinor	5	Veprimet ruajnë koherencën në vende të ndryshme brenda qytetit, duke siguruar njëkohësisht shtrirjen hapësinore si brenda ashtu edhe përtej kufijve të bashkisë (shembull: bashkëpunimi me bashkitë fqinje për promovimin e trashëgimisë disonante).
Integrimi territorial	5	Trashëgimia disonante ekziston në cdo bashki, prandaj këto veprime mund të replikohen duke u përshtatur me kontekstin lokal.
Qeverisja në shumë nivele	3	Veprimet janë planifikuar në nivel lokal, por janë në linjë me strategjitë rajonale dhe kombëtare.
Integrimi i aspekteve tematike ndërsektoriale	5	Në plan janë integruar tre aspekte tematike ndërsektoriale: digjitalizimi, gjinia dhe ekologjia.
Lloje komplementare investimi	5	Plani përfshin investime infrastrukturore dhe jo infrastrukturore.
Mobilizimi i të gjitha fondeve të disponueshme	5	Për secilin veprim u morën në konsideratë të gjitha burimet e financimit në dispozicion.



Trashëgimia disonante në Përmet përbëhet nga mbetje arkitekturore dhe kulturore nga periudha komuniste dhe pushtimi italian, duke shkaktuar debate të vazhdueshme rreth rëndësisë së tyre historike dhe rëndësisë bashkëkohore. **Pavarësisht rëndësisë së tyre të pasur historike dhe kulturore, vendet e trashëgimisë disonante në Përmet mbeten të pazhvilluara si atraksione turistike dhe edukative.**

Mirëmbajtja e dobët, aksesit i kufizuar dhe mungesa e burimeve informuese pengojnë angazhimin e vizitorëve, ndërsa promovimi i pamjaftueshëm dhe përjashtimi nga strategjitë më të gjera të turizmit e zvogëlojnë më tej dukshmërinë e tyre. Përveç kësaj, këto vende nuk shfrytëzohen sa duhet për qëllime edukative, me pak vizita nga shkollat, ruajtje të pamjaftueshme të dokumenteve historike dhe mungesë të aksesit digjital në këto objekte. Përfshirja minimale e bashkisë ose e palëve të interesuara në organizimin e aktiviteteve kulturore e kufizon më tej potencialin e tyre, duke i lënë këto vende të harruara si në përpjekjet për turizëm ashtu edhe në ato për ruajtjen e trashëgimisë.

Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, vizioni ynë i përbashkët për vendet e trashëgimisë disonante është t'i transformojmë ato në destinacione turistike të qëndrueshme dhe qendra me vlerë edukative dhe socio-kulturore. **Kjo përputhet me vizionin e zhvillimit të Bashkisë së Përmetit**, i cila i jep përparësi identifikimit, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë së pasur të qytetit, **duke kontribuar në fund të fundit në rritjen ekonomike afatgjatë dhe mirëqenien e qytetarëve të saj.**

Për të transformuar vendet e trashëgimisë disonante në destinacione turistike, së pari duhet të investojmë në përmirësimin e infrastrukturës për të lehtësuar aksesin, e më pas në **integrimin e tyre në ofertat më të gjera turistike të Përmetit**. Bashkëpunimi me operatorët turistikë, bizneset lokale dhe palët e tjera të interesuara që përfitojnë nga rritja e turizmit është thelbësor për të siguruar suksesin afatgjatë. **Kjo qasje do të krijojë një model të qëndrueshëm që rrit dukshmërinë e këtyre vendeve, duke nxitur njëkohësisht rritjen ekonomike lokale.** Përfshirja me sukses e trashëgimisë disonante në strategjinë e turizmit të Bashkisë së Përmetit jo vetëm që do të rrisë ndërgjegjësimin dhe vlerësimin për këto vende, por gjithashtu do të gjenerojë përfitime ekonomike afatgjata për komunitetin.

Trashëgimia disonante mund të jetë një mjet i fuqishëm për arsimin dhe turizmin. Vizitat, ekspozita dhe eventet komunitare që përqendrohen në rëndësinë historike dhe trashëgiminë komplekse të këtyre vendeve mund të ndihmojnë si vendasit ashtu edhe vizitorët të kuptojnë historinë shumëdimensionale të Përmetit. Iniciativa të tilla mund t'i shndërrojnë reliktet kontroverse në pika nisjeje bisedash rreth demokracisë, identitetit dhe progresit.

Duke ndjekur këtë logjikë, objektivat strategjikë, objektivat specifike dhe veprimet përkatëse janë formuluar me kujdes.

OBJEKTIVAT DHE FUSHAT E NDËRHYRJES

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: TRANSFORMIMI I VENDEVE TË TRASHËGIMISË DISONANTE NË DESTINACIONE TURISTIKE TË QËNDRUESHME.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1:

Lehtësimi i aksesit në vendet e trashëgimisë disonante.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.2:

Përfshirja e këtyre vendeve në ofertën turistike të Përmetit.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: RITJA E NDËRGJEGJËSIMIT PËR VLERËN DHE POTENCIALIN E TRASHËGIMISË DISONANTE DUKE E PËRDORUR ATË PËR QËLLIME EDUKATIVE DHE SOCIO-KULTURORE.

Objektivi specifik 2.1:

Inkurajimi i përdorimit më të mirë të potencialit të trashëgimisë disonante për qëllime edukuese.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2:

Integrimi i trashëgimisë disonante në jetën socio-kulturore të Bashkisë së Përmetit.

FUSHAT E NDËRHYRJES

TURIZËM



TRASHËGIMI KULTURORE



EDUKIM



KULTURË



VEPRIMET

Objektivi specifik 1.1: Lehtësimi i aksesit në vendet e trashëgimisë disonante.**Veprimi 1:
Dizanji dhe
vendosja
sinjalistikës
informuese në
vendet
kryesore të
trashëgimisë
disonante.**

Vendosja e tabelave informuese në këto vende synon të përmirësojë aksesin, të kuptuarit dhe prezantimin e respektueshëm të këtyre vendeve. Qëllimi është të krijohen sinjalistika që i ndihmojnë vizitorët të informohen për këto vende, të kuptojnë rëndësinë e tyre dhe të angazhohen me historitë komplekse në një mënyrë respektuese dhe kuptimplotë. Sinjalistika jo vetëm që do të ofrojë udhëzime praktike, por edhe do të lehtësojë reflektimin dhe edukimin.

**Veprimi 2:
Përmirësimi i
kushteve
fizike të
vendeve të
trashëgimisë
disonante.**

Një qasje e qëndrueshme mirëmbajtjeje është thelbësore për ruajtjen e vendeve të trashëgimisë disonante, duke siguruar sigurinë, aksesin dhe rëndësinë e tyre historike përmes inspektimeve të rregullta, pastrimit, ruajtjes dhe përpjekjeve të restaurimit. Ndërhyrjet strukturore në shkallë të vogël, të tilla si riparimi i çarjeve, restaurimi i fasadave dhe përforcimi i strukturave të dobëta, ndihmojnë në ruajtjen e integritetit historik nën drejtimin e specialistëve të konservimit. Megjithatë, për ndërhyrje në shkallë më të gjerë, Bashkia e Përmetit kërkon financim të jashtëm, duke bërë të nevojshme mbështetje nga ministritë përkatëse dhe iniciativa financimi të bazuara në projekte për të mbështetur përpjekjet afatgjata të ruajtjes.

**Veprimi 3:
Lehtësimi i
aksesit në
vendet e
trashëgimisë
disonante
përmes
përdorimit të
teknologjive
digjitale
interaktive.**

Zhvillimi i aplikacioneve VR dhe AR mund të mundësojë ture virtuale realiste të vendeve të trashëgimisë disonante, duke i bërë ato të arritshme për përdoruesit pavarësisht kufizimeve fizike ose distancës gjeografike. Duke pasur parasysh koston e lartë të VR dhe AR, një qasje alternative është krijimi i fotografive 360°, HD dhe 3D për të zhvilluar galeri interaktive ose muze virtuale të arritshëm nëpërmjet faqeve të internetit ose aplikacioneve mobile. Për të maksimizuar angazhimin global, përmbajtja duhet të jetë e disponueshme në shumë gjuhë dhe bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare duhet të inkurajohet për të promovuar ndërgjegjësimin dhe për të tërhequr një audiencë të larmishme në këto vende të trashëgimisë.

VEPRIMET

Objektivi specifik 1.2: Përfshirja e këtyre vendeve në ofertën turistike të Përmetit.**Veprimi 4:
Integrimi i
trashëgimisë
disonante në
ofertën
turistike të
Bashkisë
Përmetit.**

Bashkia e Përmetit do të përfshijë vendet e trashëgimisë disonante në Planin e saj Strategjik të Turizmit Lokal (që do të përfundojë në vitin 2025) për të nxjerrë në pah rëndësinë e tyre kulturore dhe historike. Për të rritur dukshmërinë, këto vende do të integrohen në të gjitha materialet promovuese, duke përfshirë broshurat e përditësuara, faqet e internetit, fushatat në mediat sociale dhe platformat digjitale, duke siguruar njohje më të gjerë. Përveç kësaj, do të krijohen materiale specifike promovuese si broshura, fletëpalosje, video të shkurtra dhe dokumentarë me ekspertë vendas, me të gjithë përmbajtjen e disponueshme në shumë gjuhë për të arritur një audiencë më të gjerë.

**Veprimi 5:
Bashkëpunim
me operatorët
turistikë për
përfshirjen e
trashëgimisë
disonante në
paketat e tyre
turistike.**

Bashkia e Përmetit do të promovojë trashëgiminë disonante si një aset unik turistik në takimet me operatorët turistikë, duke ofruar mbështetje për përfshirjen e saj në paketat turistike. Turet falas për operatorët, gazetarët dhe personat me ndikim do të ofrojnë përvojë të drejtpërdrejtë, duke inkurajuar interesin dhe promovimin pozitiv. Për të inkurajuar më tej përfshirjen, masat mbështetëse si materialet promovuese falas, hyrje me zbritje, asistencë në transport dhe partneritetet me bizneset lokale do të përmirësojnë përvojën e përgjithshme turistike, duke i bërë këto vende më tërheqëse dhe të arritshme.

VEPRIMET

Objektivi specifik 2.1: Inkurajimi i përdorimit më të mirë të potencialit të trashëgimisë disonante për qëllime edukuese.

**Veprimi 6:
Krijimi i
arkivit të
trashëgimisë
disonante.**

Digjitalizimi i dokumenteve të trashëgimisë disonante do të fillojë me një vlerësim gjithëpërfshirës të materialeve ekzistuese. Procesi i digjitalizimit do t'i japë përparësi të dhënave historike kryesore, duke përfshirë revistën "24 Maji", të dhënat e historisë së fshatrave, fotografitë nga Kongresi i Përmetit dhe biografite e figurave të rëndësishme. Për të rritur aksesin, një fushatë informimi dhe promovimi do të synojë studiuesit, institucionet arsimore dhe historianët përmes buletineve, mediave sociale dhe takimeve të dedikuara. Arkivi do t'i nënshtrohet përditësimeve të vazhdueshme, duke siguruar që ai të mbetet një burim i vlefshëm dhe në zhvillim për kërkime dhe edukim në të ardhmen.

**Veprimi 7:
Përdorimi i
trashëgimisë
disonante për
aktivitete
edukative.**

Bashkia do të organizojë vizita në vendet e trashëgimisë disonante, të udhëhequra nga ekspertë, për t'u ofruar studentëve përvoja mësimore gjithëpërfshirëse që nxjerrin në pah rëndësinë historike dhe ruajtjen e saj. Përveç kësaj, aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit, të tilla si tryeza të rrumbullakëta, workshope në bashkëpunim me OJQ-të dhe institucionet arsimore, do të angazhojnë publikun në diskutime mbi trashëgiminë disonante. Për të përfshirë më tej të rinjtë, iniciativat inovative si krijimi i përmbajtjes digjitale, konkurset, aktivitete artistike do të inkurajojnë qasjet krijuese dhe teknologjike ndaj ruajtjes së trashëgimisë, duke nxitur të menduarit kritik dhe pjesëmarrjen aktive.

**Veprimi 8:
Mësoni se si
qytetet e tjera
evropiane
merren me
trashëgiminë
disonante.**

Bashkia synon të forcojë përpjekjet e saj në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë disonante duke iu bashkuar organizatave ndërkombëtare, të tilla si ATRIUM, për të fituar qasje në praktikat më të mira, financimin dhe rrjetet bashkëpunuese. Gjithashtu, ajo do të marrë pjesë aktive në projekte dhe ngjarje ndërkombëtare të fokusuara në trashëgiminë disonante.

VEPRIMET

Objektivi specifik 2.2: Integrimi i trashëgimisë disonante në jetën socio-kulturore të Bashkisë.

**Veprimi 9:
Përdorimi
shumë
funksional i
vendeve të
trashëgimisë
disonante.**

Bashkia synon të përdorë vendet e trashëgimisë disonante për një sërë aktiviteteve komunitare, kulturore dhe edukative. Nëpërmjet bashkëpunimeve me OJQ-të, shkollat dhe organizatat kulturore, këto vende do të presin ekspozita, workshope, festivale dhe shfaqje, duke rritur ndërveprimin dhe ndërgjegjësimin publik. Përveç kësaj, krijimi i muzeve dhe pikave të informacionit brenda ose pranë këtyre vendeve do t'i transformojë këto vende në qendra edukuese dhe turistike, duke siguruar ruajtjen dhe integrimin e tyre në jetën kulturore për brezat e ardhshëm.

**Veprimi 10:
Organizimi i
aktiviteteve
kulturore për
trashëgiminë
disonante.**

Ky veprim synon të zhvillojë dhe zbatojë aktivitete kulturore të përqendruara në trashëgiminë disonante në Bashkinë e Përmetit. Aktivitetet do të planifikohen çdo vit, duke siguruar përfshirje dhe aksesueshmëri, duke i dhënë përparësi formateve me kosto efektive. Nëpërmjet partneriteteve strategjike me historianë vendas, organizata kulturore, universitete dhe OJQ, Bashkia do të rrisë ndërgjegjësimin historik dhe angazhimin kulturor, duke e bërë trashëgiminë disonante një pjesë integrale të identitetit kulturor vendas.

DETAJET E VEPRIMEVE



DETAJET E VEPRIMIT

VEPRIMI 1: DIZANJI DHE VENDOSJA E SINJALISTIKËS INFORMUESE NË VENDET KRYESORE TË TRASHËGIMISË DISONANTE.

HAPAT E ZBATIMIT:

Identifikimi: Hapi i parë është identifikimi i vendeve kryesore për vendosjen e tabelave bazuar në fluksin e vizitorëve dhe rëndësinë historike. Trashëgimia disonante i referohet vendeve të lidhura me të kaluarën e dhimbshme ose të kontestuar të lidhur me regjimin komunist; prandaj, është shumë e rëndësishme të përfshihen palët e interesuara gjatë fazës së identifikimit dhe vlerësimit të vendeve.

Dizajni i tabelave: Ky hap është shumë i ndjeshëm, pasi është e rëndësishme që teksti të jetë historikisht i saktë dhe neutral. Përdorimi i elementeve vizuale (foto, ilustrime, harta, linja kohore) ose kodeve QR të lidhura me burime shtesë do ta bëjë përmbajtjen më tërheqëse. Tabelat do të përfshijnë parime universale të dizajnit, siç janë shkronjat e lexueshme, Braille, tekstet dygjuhëshe (anglisht dhe shqip) dhe veçoritë e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Materialet do të jenë të qëndrueshme dhe rezistente ndaj kushteve klimaterike, por edhe vizualisht tërheqëse, si dhe miqësore me mjedisin.

Konsultimet me historianë, ekspertë të trashëgimisë dhe komunitete lokale do të sigurojnë një rrëfim të saktë dhe neutral. Për disa vende është e nevojshme të merren mendime dhe miratime për projektet nga palët e interesuara, autoritetet lokale dhe agjencitë e mbrojtjes së trashëgimisë për të siguruar përputhshmërinë me ndjeshmëritë ligjore dhe kulturore.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 1: DIZANJI DHE VENDOSJA E SINJALISTIKËS INFORMUESE NË VENDET KRYESORE TË TRASHËGIMISË DISONANTE.

Vendosja e tabelave: Ato do të vendosen në vende të dukshme dhe të arritshme që nuk pengojnë zonat e tjera kyçe. Vendosja e tyre do të jetë me ndikim minimal në mjedis.

Mirëmbajtja: Bashkia do të caktojë një plan për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rregullt të sinjalistikës për të parandaluar dëmtimin nga moti dhe zbehjen e teksteve.

Hapat	Periudha	Kostot dhe burimet e financimit
Identifikimi	2026	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet
Diznaji i tabelave	2026	Kosto e dizanjit, printimit dhe vendosjes së tre tabelave informuese- 4,000 euro. Burimi i financimit: Bashkia Përmet
Vendosja e tabelave	2026	
Mirëmbajtja	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet

Subjekti përgjegjës: Bashkia e Përmetit

Partnerët: Institucione të trashëgimisë kulturore, historianë, institucione arsimore, operatorë turistikë, anëtarë të ULG-së.

DETAJIMI I VEPRIMIT

TREGUESIT E MONITORIMIT

Treguesi	Objektivi
Numri i tabelave informuese të instaluara në vendet e trashëgimisë disonante.	Të paktën 3 brenda vitit 2026

ANALIZA E RISKUT

Risku	Strategjia e Zbutjes
Kundërshtimi ose ndjeshmëria e komunitetit: Vendet e trashëgimisë disonante mund të jenë të diskutueshme për grupe ose individë të caktuar. Gjë që mund të çojë në kundërshtim të mundshëm ndaj sinjalistikës ose përmbajtjes së saj.	-Angazhohuni me komunitetin, ekspertët dhe palët e tjera të interesuara që në fillim të procesit për të siguruar që pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre të përfshihen në dizajnin e sinjalistikës.
Keqinterpretimi i Historisë së Vendit të Trashëgimisë: Sinjalistika mund ta thjeshtësojë pa dashje, ta keqinterpretojë ose të mos adresojë kompleksitetin e plotë të historisë së vendit të trashëgimisë kulturore.	-Punoni me historianë ekspertë, anëtarë të komunitetit dhe këshilltarë kulturorë për të siguruar përmbajtje të saktë dhe të ekuilibruar. -Ofroni rrugë për të mësuar më tej, të tilla si lidhje me burime, ture me guidë ose programe edukative.
Moti dhe konsumimi me kalimin e kohës: Ekspozimi ndaj kushteve të ashpra të motit mund të shkaktojë zbehjen, palexueshmërinë ose përkeqësimin e sinjalistikës.	- Përdorni materiale me cilësi të lartë, rezistente ndaj motit, të cilat janë të projektuara për t'i rezistuar klimës lokale. -Zbatoni një plan të vazhdueshëm mirëmbajtjeje për të inspektuar, pastruar dhe zëvendësuar sinjalistikën e dëmtuar sipas nevojës.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 2: PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE FIZIKE TË VENDEVE TË TRASHËGIMISË DISONANTE.

HAPAT E ZBATIMIT:

Mirëmbajtja e vazhdueshme e vendeve të trashëgimisë disonante: Përpyekjet e mirëmbajtjes do të përqendrohen fillimisht në 5 vende të trashëgimisë disonante. Disa prej tyre janë monumente të mbrojtura kulturore, prandaj është e nevojshme koordinimi me institucionet përgjegjëse. Përpyekjet e mirëmbajtjes do të përfshijnë pastrim rutinë brenda dhe përreth vendeve, mirëmbajtjen e rrugëve dhe shtigjeve që të çojnë në këto vende dhe identifikimin e shenjave të përkeqësimit. Kjo do të kryhet nga Sektori i Pastrimit dhe Mirëmbajtjes në Bashki.

Ndërrhyrje Strukturore në Shkallë të Vogël: Këto përpjekje përfshijnë riparime të vogla, të tilla si rregullimi i çarjeve, restaurimi i fasadave dhe përforcimi i strukturave të dobëta duke përdorur teknika miqësore ndaj mjedisit. Për të siguruar autenticitetin dhe efektivitetin, specialistët e konservimit do të mbikëqyrin këto ndërrhyrje, duke mbështetur konservimin afatgjatë dhe angazhimin publik.

Kërkimi i mbështetjes për ndërrhyrje në shkallë të madhe: Bashkia e Përmetit nuk ka fondet e nevojshme për ndërrhyrje në shkallë të madhe në vendet e trashëgimisë disonante. Për ta adresuar këtë, departamenti i projekteve dhe planifikimit urban do të kërkojë mbështetje nga ministritë përkatëse dhe do të aplikojë për projekte që financojnë ndërrhyrje të tilla në shkallë të gjerë në këto vende.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 2: PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE FIZIKE TË VENDEVE TË TRASHËGIMISË DISONANTE.

Hapi	Periudha	Kostot dhe burimi i financimit
Mirëmbajtje e vazhdueshme e vendeve të trashëgimisë disonante.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia e Përmetit.
Ndërhyrje Strukturore në Shkallë të Vogël.	Vazhdimësi	Kostot: afërsisht 8,000 euro në vit Burimi i financimit: Bashkia e Përmetit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ose fonde të donatorëve të huaj.
Kërkimi i mbështetjes për ndërhyrje në shkallë të madhe.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia e Përmetit.

Subjekti përgjegjës: Bashkia e Përmetit

Partnerët: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, institucionet e trashëgimisë kulturore, specialistët e trashëgimisë kulturore, anëtarët e ULG-së.

DETAJIMI I VEPRIMIT

TREGUESIT E MONITORIMIT

Treguesi	Objektivi
Numri i vendeve të trashëgimisë disonante që mirëmbahen rregullisht.	Të paktën 5
Numri i vendeve të trashëgimive disonante mbi të cilat u kryen ndërhyrje në shkallë të vogël.	Të paktën 3 brenda vitit 2028

ANALIZA E RISKUT

Risku	Strategjia e zbutjes
Keqinterpretimi Kulturor dhe Kundërshtimi Publik: Ndërhyrjet në vendet e trashëgimisë disonante mund të përballen me kundërshtim publik ose keqinterpretim kulturor nëse shihen si mungesë respekti ose në përputhje me vlerat e komunitetit.	Përfshijini të gjithë palët e interesuara në procesin e vendimmarrjes. Zhvilloni programe informimi, të tilla si ekspozita, workshope dhe ture me guidë, që edukojnë publikun rreth qëllimit dhe përfitimeve të ndërhyrjeve.
Mungesa e fondeve: Pa fonde të mjaftueshme për restaurim dhe menaxhim, projektet mund të përballen me vonesa ose anulime, duke rrezikuar përkeqësimin e vendit dhe humbjen e trashëgimisë kulturore.	Burim i diversifikuar i financimit. Përfshijini këto ndërhyrje në planet strategjike.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 3: LEHTËSIMI I AKSESIT NË VENDET E TRASHËGIMISË DISONANTE DUKE PËRDORUR TEKNOLOGJITË DIGJITALE INTERAKTIVE.

HAPAT E ZBATIMIT:

Përdorimi i Realitetit Virtual (VR) dhe Realitetit të Shtuar (AR): Zhvilloni aplikacione VR dhe AR që simulojnë vizitat në vende të trashëgimisë disonante, duke u lejuar përdoruesve të përjetojnë një tur realist të vendeve që janë shumë larg ose të vështira për t'u arritur. Kjo është e nevojshme për të mundësuar eksplorimin në distancë dhe interaktiv të vendeve të trashëgimisë disonante, veçanërisht atyre që janë fizikisht të paarrtshme ose të ndjeshme, siç janë tunelet, bunkerët ose strehimoret.

Krijimi i fotografive 360°, HD dhe 3D të vendeve të trashëgimisë kulturore: Aplikacionet VR dhe AR mund të jenë shumë të kushtueshme, kështu që për disa vende mund të fillojmë me krijimin e fotografive me cilësi të lartë. Këto foto mund të përdoren për të krijuar galeri interaktive ose muze virtuale të aksesueshëm për publikun nëpërmjet faqeve të internetit ose aplikacioneve mobile.

Promovimi : Përmbajtja duhet të jetë e arritshme në shumë gjuhë për të arritur një audiencë të larmishme globale. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe promovimi i vazhdueshëm do të tërheqin vëmendjen ndërkombëtare ndaj sitit të trashëgimisë.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 3: LEHTËSIMI I AKSESIT NË VENDET E TRASHËGIMISË DISONANTE DUKE PËRDORUR TEKNOLOGJITË DIGJITALE INTERAKTIVE.

Hapi	Periudha	Kostot dhe burimi i financimit
Përdorimi i Realitetit Virtual (VR) dhe Realitetit të Shtuar (AR).	2026-2028	Kosto - 40,000 euro. Burimi i financimit - Projektet e Bashkimit Evropian (URBACT, CERV, Interreg, Horizon Europe, Erasmus+ etj.) + fondet e donatorëve të tjerë.
Krijimi i fotografive 360°, HD dhe 3D të vendeve të trashëgimisë kulturore.	2025-2027	Kosto - 20,000 euro Burimi i financimit - Projektet e Bashkimit Evropian (URBACT, CERV, Interreg, Horizon, Erasmus+ etj.) + fondet e donatorëve të tjerë.
Promovimi	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet

Subjekti përgjegjës: Bashkia e Përmetit

Partnerët: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, historianë, ekspertë të kulturës, operatorë turistikë, anëtarë të ULG-së, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare, institucionet arsimore.

DETAJIMI I VEPRIMIT

TREGUESIT E MONITORIMIT

Treguesi	Objektivi
Numri i vendeve të trashëgimisë disonante të aksesueshme përmes teknologjive digjiitale interaktive.	Të paktën 2 brenda vitit 2028

ANALIZA E RISKUT

Risku	Strategjia e Zbutjes
Kosto të larta të zhvillimit të VR dhe AR: ato kërkojnë teknologji të përparuar, profesionistë të aftë dhe krijim të gjerë përmbajtjeje, duke e bërë zbatimin e kushtueshëm për promovimin e vendeve të trashëgimisë.	-Filloni me fotografinë dhe galeritë interaktive si një hap i parë më efektiv nga ana e koston përpara se të kaloni në zhvillimin e realitetit virtual. -Kërkoni fonde nga donatorë ndërkombëtare për ruajtjen e trashëgimisë, fushata për mbledhje fondesh ose partneritete me kompani teknologjike për të ulur kostot. -Jepni përparësi një qasje zhvillimi me faza, duke u përqendruar fillimisht në disa vende ose elementë kryesorë përpara se të zgjeroheni.
Saktësia Historike dhe Përfaqësimi Etik: I referohet keqinterpretimit ose thjeshtësimit të tepërt të narrativave historike të ndjeshme.	-Bashkëpunoni me historianë, ekspertë kulturorë dhe komunitete lokale për të siguruar saktësi dhe rrëfim të respektueshëm.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 4: INTEGRIMI I TRASHËGIMISË DISONANTE NË OFERTËN TURISTIKE TË BASHKISË PËRMET.

HAPAT E ZBATIMIT:

Përfshirja e trashëgimisë disonante në planin strategjik lokal të turizmit : Bashkia e Përmetit do të përfundojë Planin Strategjik Lokal të Turizmit në vitin 2025, dhe ne do të përfshijmë në këtë strategji këto vende të trashëgimisë disonante dhe veprimet e propozuara në Planin e Veprimit (IAP). Kjo do të ndihmojë që këto vende të njihen si asete kryesore kulturore dhe historike me potencial të lartë turistik, duke e bërë më të lehtë aksesin në fonde dhe mbështetje për ruajtjen, promovimin dhe aksesin e tyre.

Përfshirja e vendeve të trashëgimisë disonante në të gjitha materialet promovuese të bashkisë: Integrimi i vendeve të trashëgimisë disonante në materialet promovuese të Bashkisë së Përmetit është çelësi për rritjen e dukshmërisë së tyre. Kjo përfshin përditësimin e broshurave, faqeve të internetit dhe platformave digjiitale, duke promovuar në mënyrë aktive këto vende përmes portaleve të turizmit online, mediave sociale dhe fushatave të synuara. Kjo qasje do të rrisë njohjen e tyre, duke tërhequr më shumë vizitorë dhe duke ngritur statusin e tyre si atraksione kulturore dhe historike. Në fakt, vetëm Salla e Kongresit është përfshirë në materialet promovuese.

Përgatitja e materialeve specifike promovuese për trashëgiminë disonante: Kjo përfshin krijimin e broshurave informuese, fletëpalosjeve dhe materialeve të tjera për të ofruar kontekst historik, së bashku me video dhe dokumentarë të shkurtër që paraqesin ekspertë vendas. Për të arritur një audiencë më të gjerë, të gjitha materialet do të jenë të disponueshme në shumë gjuhë, duke promovuar trashëgiminë disonante si një pjesë jetësore të turizmit kulturor të rajonit.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 4: INTEGRIMI I TRASHËGIMISË DISONANTE NË OFERTËN TURISTIKE TË BASHKISË SË PËRMETIT.

Hapi	Periudha	Kostot dhe burimi i financimit
Përfshirja e trashëgimisë disonante në planet strategjike lokale të turizmit.	2025	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet.
Përfshirja e vendeve të trashëgimisë disonante në të gjitha materialet promovuese të bashkisë.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet.
Përgatitja e materialeve specifike promovuese për trashëgiminë disonante.	2026-2027	Kosto: 15,000 euro (përgatitja e videove, materialeve të printuara dhe digjiitale) Burimi i financimit: Bashkia e Përmetit dhe fonde të donatorëve vendas dhe të huaj.

Subjekti përgjegjës: Bashkia e Përmetit

Partnerët: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, historianë, ekspertë të kulturës, institucione arsimore, Këshilli Rinor, anëtarë të ULG-së

DETAJIMI I VEPRIMIT

TREGUESIT E MONITORIMIT

Treguesi	Objektivi
Numri i vendeve të trashëgimisë disonante të përfshira në materialet promovuese.	Të paktën 3 brenda vitit 2026
Numri i materialeve specifike promovuese të përgatitura për vendet e trashëgimisë disonante.	Të paktën 10 brenda vitit 2027

ANALIZA E RISKUT

Risku	Strategjia e Zbutjes
Keqinterpretimi Kulturor dhe Kundërshtimi Publik: Promovimi i vendeve të trashëgimisë disonante mund të përballët me kundërshtim publik ose keqinterpretim kulturor nëse shihet si mungesë respekti ose jo në përputhje me vlerat e komunitetit.	-Angazhoni komunitetet lokale në zhvillimin e materialeve promovuese për të siguruar që narrativat e paraqitura të jenë respektuese, të sakta dhe gjithëpërfshirëse të perspektivave të ndryshme. -Bashkëpunoni me historianë dhe ekspertë kulturorë lokalë për të promovuar vendet në një mënyrë që i edukon vizitorët rreth rëndësisë së tyre pa e nënvlerësuar historinë e tyre.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 5: BASHKËPUNIM ME OPERATORËT TURISTIKË PËR PËRFSHIRJEN E TRASHËGIMISË DISONANTE NË PAKETAT E TYRE TURISTIKE.

HAPAT E ZBATIMIT:

Promovimi i potencialit turistik të trashëgimisë disonante gjatë takimeve me operatorët turistikë:

Bashkia e Përmetit organizon takime periodike me operatorët turistikë në nivele të ndryshme, sepse turizmi është një nga sektorët kryesorë të zhvillimit. Gjatë këtyre takimeve ne do të theksojmë potencialin e trashëgimisë disonante si një aset unik turistik dhe do të theksojmë se do t'i mbështesim ata nëse i përfshijnë këto vende në ofertën e tyre turistike. Do të fillojmë duke promovuar vendet që janë lehtësisht të arritshme për vizitorët dhe ato për të cilat kemi informacion të besueshëm.

Organizimi i tureve falas në vendet e trashëgimisë disonante:

Turet falas në vendet e trashëgimisë disonante synojnë t'u japin operatorëve turistikë, gazetarëve, bloggerëve dhe personave me ndikim përvojë të drejtpërdrejtë të rëndësisë së tyre kulturore dhe historike. Të udhëhequra nga guida eksperte, këto ture do të rrisin mirëkuptimin, do të inkurajojnë përfshirjen në ofertat turistike dhe do të gjenerojnë dëshmi pozitive për promovim në të ardhmen, duke rritur në fund të fundit interesin dhe angazhimin e vizitorëve.

Mbështetja e operatorëve turistikë që përfshijnë vende të trashëgimisë disonante në paketat e tyre turistike:

Qëllimi i këtij hapi është të inkurajojë dhe lehtësojë përfshirjen e tyre duke ofruar stimuj të ndryshëm dhe mbështetje logjistike. Për ta arritur këtë, ne do të ofrojmë materiale promovuese falas, hyrje me zbritje ose falas në këto vende dhe ndihmë me transportin. Përveç kësaj, do të krijohen partneritete me bizneset lokale, duke përfshirë hotelet dhe restorantet, për të krijuar oferta të që përmirësojnë përvojën e përgjithshme turistike, duke e bërë më tërheqëse për operatorët që t'i përfshijnë këto vende në paketat e tyre.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 5: BASHKËPUNIM ME OPERATORËT TURISTIKË PËR PËRFSHIRJEN E TRASHËGIMISË DISONANTE NË PAKETA TYRE TURISTIKE.

Hapi	Periudha	Kostot dhe burimi i financimit
Promovoni potencialin turistik të trashëgimisë disonante gjatë takimeve me operatorët turistikë.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet.
Organizimi i tureve falas në vendet e trashëgimisë disonante.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet.
Mbështetja e operatorëve turistikë që përfshijnë vende të trashëgimisë disonante në paketat e tyre turistike.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet.

Subjekti përgjegjës: Bashkia e Përmetit

Partnerët: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, historianë, ekspertë të kulturës, operatorë turistikë, biznese lokale, anëtarë të ULG-së.

DETAJIMI I VEPRIMIT

TREGUESIT E MONITORIMIT

Treguesi	Objektivi
Numri i Operatorëve Turistikë të Përfshirë	Të paktën 5 brenda vitit 2026
Numri i tureve të organizuara në vendet e trashëgimisë disonante	Të paktën 10 brenda vitit 2026

ANALIZAE RISKUT

Risku	Strategjia e Zbutjes
Interesi i kufizuar nga operatorët turistikë rrjedh nga shqetësimet në lidhje me qëndrueshmërinë tregtare, aksesueshmërinë dhe tërheqjen e vendeve të trashëgimisë disonante. Operatorët mund të hezitojnë t'i përfshijnë ato për shkak të kërkesës së ulët të perceptuar, infrastrukturës së pamjaftueshme ose natyrës së tyre kontraverse. Shpesh u jepet përparësi destinacioneve të njohura me trafik më të lartë turistik dhe tërheqje të gjerë.	- Theksoni kërkesën në rritje për turizëm kulturor dhe alternativ, i cili vlerëson përvojat gjithëpërfshirëse dhe unike. - Bashkohuni me operatorë turistikë të specializuar në turizmin historik dhe kulturor. - Bashkëpunoni me bashkitë fqinje për të krijuar një paketë rajonale që paraqet vende të trashëgimisë disonante.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 6: KRIJIMI I ARKIVIT DIGJITAL TË TRASHËGIMISË DISONANTE.

HAPAT E ZBATIMIT:

Vlerësimi dhe inventarizimi i dokumenteve ekzistuese: Ky hap përfshin një studim gjithëpërfshirës të të gjitha materialeve fizike që lidhen me trashëgiminë disonante. Ai përfshin identifikimin e dokumenteve, librave, dorëshkrimeve, fotografive dhe materialeve të tjera relevante ekzistuese që do të digjitalizohen.

Procesi i digjitalizimit: Nisma e digjitalizimit fillimisht do të përqendrohet në katër kategori kryesore dokumentesh: revista “24 Maji”, e cila ofron njohuri historike të periudhës së komunizmit; të dhënat e historisë së fshatrave, që dokumentojnë trashëgiminë lokale dhe evolucionin kulturor; fotografitë që lidhen me Kongresin e Përmetit, që kapin momente të rëndësishme historike; dhe biografitë e figurave të rëndësishme, duke ruajtur historitë e individëve me ndikim.

Promovimi: Përfshin shpërndarjen dhe sigurimin e aksesit në materiale për studiuesit, institucionet arsimore, historianët dhe individë të tjerë të interesuar. Për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të inkurajuar përdorimin, do të lançohet një fushatë informimi, duke përfshirë përpjekje promovuese si buletine me email, angazhim në mediat sociale dhe takime specifike që synojnë studiuesit, organizatat kulturore dhe institucionet arsimore. Përveç kësaj, bashkëpunimi me shkollat dhe universitetet do të ndihmojë në integrimin e materialeve në kurrikulat akademike përmes workshopeve dhe leksioneve, duke nxitur angazhimin arsimor.

Përditësime të vazhdueshme: Së fundmi, arkivi do të përditësohet vazhdimisht me materiale të digjitalizuara dhe do të mirëmbahet për të siguruar mbështetje të vazhdueshme për përdoruesit, duke siguruar që ai të mbetet një burim i vlefshëm për vitet në vazhdimësi.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 6: KRIJIMI I ARKIVIT DIGJITAL TË TRASHËGIMISË DISONANTE.

Hapi	Periudha (2025- 2026)	Kostot dhe burimi i financimit
Vlerësim dhe Inventarizim	Muaji 1–3	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet.
Digjiitalizimi	Muaji 3-10	Ekspert i IT-së - 10,000 euro Burimi i financimit: Bashkia e Përmetit dhe fonde nga donatorë vendas dhe të huaj.
Promovim	Muaji 10–18	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet.
Përditësime të vazhdueshme	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia .

Subjekti përgjegjës: Bashkia Përmet.

Partnerët: Ekspertë të trashëgimisë kulturore, historianë, institucione arsimore, anëtarë të ULG-së, OJQ.

DETAJIMI I VEPRIMIT

TREGUESIT E MONITORIMIT

Treguesi	Objektivi
Numri i kategorive të dokumenteve të digjitalizuara.	Të paktën 4 kategori dokumentesh brenda vitit 2025
Numri i shkollave ose universiteteve që përdorin arkivin.	Të paktën 4 shkolla brenda vitit 2026
Numri i përdoruesve që aksesojnë arkivin.	Të paktën 30 përdorues çdo vit

ANALIZA E RISKUT

Rrezik	Strategjia e Zbutjes
Shtrirje e pamjaftueshme: i referohet përpjekjeve të pamjaftueshme ose dështimit për të promovuar në mënyrë efektive arkivin dixhital tek audiencat kryesore të synuara.	Bashkëpunoni me institucionet dhe ekspertët vendas për shtrirje të synuar dhe përdorni një sërë mediash për të arritur grupe të ndryshme.
Humbja e Cilësisë së Dokumentit gjatë Dixhitalizimit i referohet përkeqësimit ose degradimit të qartësisë, saktësisë ose integritetit të materialeve origjinale gjatë procesit të dixhitalizimit.	Përdorni pajisje profesionale skanimit dhe ekspert të IT-së.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 7: INTEGRIMI I TRASHËGIMISË DISONANTE NË AKTIVITETE EDUKUESE.

HAPAT E ZBATIMIT:

Organizimi i vizitave në vendet e trashëgimisë disonante, ku studentët mund të bashkëveprojnë drejtpërdrejt me këto vende dhe të mësojnë rreth rëndësisë së tyre historike. Këto vizita do të drejtohen nga ekspertë të Bashkisë dhe profesorë të cilët mund të ofrojnë informacion të saktë, duke e bërë përvojën edukative dhe gjithëpërfshirëse.

Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere për trashëgiminë disonante në bashkëpunim me OJQ-të, institucionet arsimore etj.: Përveç vizitave, do të organizohen një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuere (tryeza të rrumbullakëta, workshop dhe madje edhe flashmobs) në bashkëpunim me OJQ-të, institucionet arsimore dhe partnerë të tjerë. Iniciativa të tilla jo vetëm që do të rrisin ndërgjegjësimin, por edhe do të përfshijnë në mënyrë aktive komunitetin në diskutime rreth narrativave historike dhe rolit të trashëgimisë në shoqëri.

Organizimi i aktivitete inovative dhe tërheqëse për të rinjtë dhe mësuesit, të përqendruara në trashëgiminë disonante: Mund të zbatohen një sërë qasjesh krijuese, si: workshop interaktiv ku të rinjtë krijojnë përmbajtje digjitale, të tilla si podcaste, video ose art digital, bazuar në kuptimin e tyre të trashëgimisë disonante; konkurse; ngjarjet artistike dhe konkurset krijuese i sfidojnë të rinjtë të hartojnë zgjidhje inovative për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë disonante, duke inkurajuar të menduarit kritik dhe përdorimin e teknologjisë në ruajtjen e kulturës. Është e rëndësishme të angazhohen edhe mësuesit në mënyrë që ata të mund t'i përsërisin vetë këto aktivitete në të ardhmen.

DETAJE TË PLANIFIKIMIT TË VEPRIMIT

VEPRIMI 7: INTEGRIMI I TRASHËGIMISË DISONANTE NË AKTIVITETET EDUKUESE.

Hapi	Periudha	Kostot dhe burimi i financimit
Organizimi i tureve me guidë.	Në vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet.
Organizimi i aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit.	Në vazhdimësi	Kostoja: 6,000 në vit (kosto logjistike + ekspertë) Burimi i financimit: Bashkia Përmet + projekte të Bashkimit Evropian (URBACT, CERV, Interreg, Horizon Europe, Erasmus+ etj.) + fonde të donatorëve të tjerë.
Organizoni aktivitete inovative dhe tërheqëse për të rinjtë dhe mësuesit.	Në vazhdimësi	Kostoja: 6,000 në vit (kosto logjistike + ekspertë) Burimi i financimit: Bashkia e Përmetit + projekte të Bashkimit Evropian (URBACT, CERV, Interreg, Horizon Europe, Erasmus+ etj.) + fonde të donatorëve të tjerë.

Subjektet përgjegjëse: Bashkia e Përmetit, institucionet arsimore (shkollat + universitetet), OJQ-të që zbatojnë projekte të ngjashme në Bashkinë e Përmetit.

Partnerët: Ekspertë të trashëgimisë kulturore, institucione kulturore, Këshilli Rinor, OJQ-të, institucionet arsimore, anëtarët e Njesisë së Qeverisjes Vendore.

DETAJIMI I VEPRIMIT

TREGUESIT E MONITORIMIT

Treguesi	Objektivi
Numri i studentëve që marrin pjesë në aktivitetet edukuese.	Të paktën 100 studentë çdo vit
Numri i aktiviteteve të organizuara për rritjen e ndërgjegjësimit.	Të paktën 2 aktivitete çdo vit
Numri i ngjarjeve inovative për të rinjtë.	Të paktën një aktivitet çdo vit

ANALIZA E RISKUT

Risku	Strategjia e Zbutjes
Pjesëmarrja e ulët e studentëve: Shpesh vjen nga mosinteresi, keqkuptimi ose integriteti i dobët i kurrikulës, gjë që çon në mosangazhim dhe ulje të ndikimit.	-Bëjini aktivitetet pjesë të kurrikulave shkollore dhe përfshijini në mënyrë aktive mësuesit në promovimin e këtyre ngjarjeve. -Ofroni stimuj të tillë si certifikata ose njohje për pjesëmarrje.
Angazhim i kufizuar nga publiku për shkak të faktorëve si mungesa e ndërgjegjësimit, interesit ose njohjes, si dhe kompleksiteti i perceptuar i tematikës.	Përdorni metoda krijuese dhe tërheqëse , të tilla si flashmobs ose shfaqje publike interaktive, për të tërhequr komunitetet lokale dhe për të gjeneruar një interes më të gjerë në trashëgiminë disonante.
Çështje të Ndjeshmërisë Kulturore: Trashëgimia disonante mund të përfshijë tema të diskutueshme ose të ndjeshme, dhe të rinjtë mund t'i keqinterpretojnë ose t'i trajtojnë ato jo si duhet gjatë aktiviteteve krijuese.	Përfshini udhëzime dhe mbikëqyrje nga ekspertë gjatë aktiviteteve për të siguruar që temat e ndjeshme trajtohen në mënyrë të përshtatshme. Organizoni workshope ose materiale mbi ndjeshmërinë kulturore për të ndihmuar të rinjtë të angazhohen me respekt me temën.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 8: MËSONI SI QYTETET E TJERA EVROPIANE TRAJTOJNË TRASHËGIMINË DISONANTE.

HAPAT E ZBATIMIT:

Anëtarësimi në Organizata Ndërkombëtare që fokusohen në trashëgiminë disonante: Për të forcuar përpjekjet në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë disonante, Bashkia do të kërkojë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare të dedikuara për këtë kauzë. Ne synojmë të bëhemi anëtar i ATRIUM-it (Arkitektura e Regjimeve Totalitare të Shekullit të 20-të në Evropën Qendrore dhe Lindore), një organizatë që punon në ruajtjen dhe interpretimin e trashëgimisë disonante.

Pjesëmarrja në Projekte të Fokusuara në Trashëgiminë Disonante: Përveç kësaj, Bashkia do të prioritetizojë aplikimet për projekte ndërkombëtare që me fokus trashëgiminë disonante. Këto projekte mund të përfshijnë ruajtjen, interpretimin dhe ripërdorimin adaptiv të ndërtesave dhe monumenteve kontroverse, duke kontribuar në një kuptim dhe ripërdorim më të thellë të këtyre vendeve. Duke u angazhuar në nisma të tilla, Bashkia mund të ketë qasje në burime, ekspertizë dhe fonde për të çuar më tej misionin e saj të integritetit të trashëgimisë disonante në aktivitetet kulturore dhe komunitare.

Pjesëmarrja e palëve të interesuara dhe stafit të Bashkisë në evente ndërkombëtare: Përfshirja e palëve të interesuara dhe stafit në evente ndërkombëtare, të tilla si konferenca dhe punëtori, do t'u lejojë atyre të mësojnë nga përvojat e qyteteve të tjera evropiane. Duke u angazhuar në këto ngjarje, bashkia mund të miratojë praktikatat më të mira duke ndarë njohuritë e veta, duke forcuar në fund të fundit qasjen e saj ndaj trashëgimisë disonante.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 8: MËSONI SI QYTETET E TJERA EVROPIANE TRAJTOJNË TRASHËGIMINË DISONANTE.

Hapi	Periudha	Kostot dhe burimi i financimit
Anëtarisimi në organizata ndërkombëtare që fokusohen në trashëgiminë disonante	Brenda vitit 2025	Kosto: 830 euro - tarifa vjetore e anëtarësimit në ATRIUM. Burimi i financimit: Bashkia Përmet.
Pjesëmarrja në Projekte të Fokusuara në Trashëgiminë Disonante	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet.
Pjesëmarrja e palëve të interesuara dhe stafit të Bashkisë në evente ndërkombëtare.	Vazhdimësi	Kosto: 4,000 euro në vit (kosto udhëtimi + akomodimi) Burimi i financimit: Bashkia Përmet + buxheti i projektit.

Subjekti përgjegjës: Bashkia e Përmetit

Partnerët: Organizata ndërkombëtare, institucione arsimore, OJQ, anëtarë të Njesisë Vendore të Qeverisjes Vendore.

DETAJIMI I VEPRIMIT

TREGUESIT E MONITORIMIT

Treguesi	Objektivi
Numri i organizatave ndërkombëtare të anëtarësuara.	Të paktën një
Numri i stafit dhe palëve të interesuara që marrin pjesë në evente ndërkombëtare.	Të paktën 6 persona çdo vit
Numri i aplikimeve në projekte për trashëgimi disonante.	Të paktën një aplikim çdo vit

ANALIZA E RISKUT

Risku	Strategjia e Zbutjes
Mundësi të Kufizuara Ndërkombëtare ose Vonesa në Miratimin e Anëtarësimit: Procesi i aplikimit për organizatat ose projektet ndërkombëtare mund të zgjasë më shumë se sa pritej, duke vonuar pjesëmarrjen.	Filloni procesin e aplikimit herët dhe ndiqni rregullisht organet përkatëse. Eksploroni organizata dhe iniciativa të shumta për të siguruar mundësi të larmishme për angazhim.
Sfidat në Përshtatjen e Projekteve Ndërkombëtare me objektivat lokale të ruajtjes së trashëgimisë, duke çuar në rezultate joefektive.	Zgjidhni me kujdes projektet që lidhen drejtpërdrejt me nevojat lokale.
Mungesë angazhimi nga palët e interesuara dhe stafi i Bashkisë për shkak të kufizimeve kohore, financiare ose logjistike.	Jepni stimuj të tillë si mbështetje për udhëtime, mundësi mësimi ose përfitime për rrjetëzim.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 9: PËRDORIMI MULTIFUNKSIONAL I VENDEVE TË TRASHËGIMISË DISONANTE.

HAPAT E ZBATIMIT:

Përzgjedhja dhe vlerësimi: Hapi i parë është identifikimi i vendeve të trashëgimisë disonante me rëndësi historike, integritet strukturor dhe aksesueshmëri duke përdorur studime, vlerësime ekspertësh dhe konsultime me historianët. Bashkia më pas mund të zgjedhë vende të sigurta dhe gjithëpërfshirëse që balancojnë ruajtjen e trashëgimisë me nevojat moderne të komunitetit dhe të krijojë partneritete me OJQ-të lokale, shkollat, artistët dhe organizatat kulturore për përdorimin e tyre.

Përdorimi i vendeve të trashëgimisë disonante për organizimin e aktiviteteve të ndryshme nga bashkia ose palët e tjera të interesuara: Pas vlerësimit të përshtatshmërisë së vendeve të trashëgimisë disonante, Bashkia do të promovojë në mënyrë aktive përdorimin e tyre për aktivitete kulturore, edukuese dhe të drejtuara nga komuniteti, edhe nëse ato nuk lidhen drejtpërdrejt me trashëgiminë disonante, si ekspozita, workshope, festivale dhe shfaqje. Ndërsa monumenti që përkujton Kongresin e Përmetit, i vendosur në qendër të qytetit, mbetet një vend kyç për ngjarje të mëdha, aktivitetet e fundit të udhëhequra nga OJQ-të në vende të tjera kanë rritur dukshmërinë dhe kanë nxitur shkëmbimin kulturor.

Ngritja e muzeve dhe pikave të informacionit në vendet e trashëgimisë disonante: Për më tepër, krijimi i muzeve dhe pikave të informacionit turistik në ose pranë vendeve të trashëgimisë disonante mund t'i shndërrojë ato në qendra edukuese dhe turistike. Për shembull, Muzeu i Luftës në Sallën e Kongreseve tërheq entuziastët e historisë; atraksione të ngjashme pranë vendeve të tjera mund të rrisin dukshmërinë dhe integrimin kulturor.

DETAJIMI I VEPRIMIT

VEPRIMI 9: PËRDORIMI MULTIFUNKSIONAL I VENDEVE TË TRASHËGIMISË DISONANTE.

Hapi	Periudha	Kostot dhe burimi i financimit
Përzgjedhja dhe vlerësimi i vendit.	Vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet.
Përdorimi i vendeve të trashëgimisë disonante për organizimin e aktiviteteve të ndryshme.	Në vazhdimësi	Kontribut në natyrë nga Bashkia Përmet + kostot e mbuluara nga buxheti i projektit të OJQ-ve ose institucioneve kulturore që organizojnë aktivitetet.
Ngritja e muzeve dhe pikave të informacionit në vendet e trashëgimisë disonante.	2025-2028	Kostoja e pikës së informacionit - 900,000 euro Burimi i financimit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Subjekti përgjegjës: Bashkia e Përmetit, OJQ-të, institucionet kulturore, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Partnerët: Ekspertë të trashëgimisë kulturore, institucione kulturore, institucione arsimore, Këshilli Rinor, OJQ-të, anëtarët e ULG-së.

DETAJIMI I VEPRIMIT

TREGUESIT E MONITORIMIT

Treguesi	Objektivi
Numri i aktiviteteve të organizuara në vendet e trashëgimisë disonante.	Të paktën 4 aktivitete çdo vit
Numri i pjesëmarrësve që marrin pjesë në këto aktivitete.	Gjithsej 300 pjesëmarrës çdo vit
Numri i vendeve të trashëgimisë disonante të përdorura për krijimin e muzeve, pikave të informacionit etj.	Një brenda vitit 2028

ANALIZA E RISKUT

Risku	Strategjia e Zbutjes
Mungesa e interesit ose e angazhimit nga publiku: Publiku mund të mos jetë i interesuar të vizitojë ose të marrë pjesë në aktivitete në vendet e trashëgimisë disonante, duke çuar në pjesëmarrje të ulët.	-Sigurohuni që aktivitetet të jenë të rëndësishme për audienca të ndryshme dhe përdorni marketing dhe partneritete të synuara për t'i tërhequr ato.
